



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Syllabusi i lëndës: Politika Monetare

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Biznesit - KF
Titulli i lëndës:	Politika Monetare
Niveli:	Master
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	II
Numri i orëve në javë:	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	
Detajet kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës	Lënda është dizajnuar që t'i familjarizojë studentët me çështjet praktike dhe teorike të politikave monetare në vendet e zhvilluara me ekonomi te tregut dhe kornizën institucionale, konceptet kryesore lidhur me teorinë dhe praktikën e politikave monetare si dhe ndikimi i saj në ekonominë nacionale, si dhe njohuri baze mbi instrumentet dhe tregjet financiare, normat e interesit, institucionet financiare dhe kurset ndërkombëtare të këmbimit
Qëllimet e lëndës:	Qëllim kryesor i këtij moduli është që studentët të njihen me: • Politikat monetare si dhe ndikimi i tyre në ekonominë nacionale; • Shfrytëzimi i politikave monetare për të ndikuar në objektivat baze ekonomike si stabiliteti i çmimeve, rritje ekonomike, punësimi i plotë dhe ekuilibri i bilancit të pagesave

Rezultatet e pritura të nxënies:			
Njohuri (NJ): *NJ1. Të kuptojnë teoritë e ndryshme lidhur me ofertën dhe kërkesën për para. *NJ2. Të kuptojë ndikimin e instrumenteve monetare të politikë bërësve Aplikim-Kompetenca (A-K): **A1. Të kalkulojnë normat e interesit me metoda të ndryshme. **A2. Të përshkruaj efektet e politikës monetare në ekonominë e përgjithshme Aftësi (A): ***A1. Të jetë në gjendje të krijojë raporte dhe bëjë prezantimin e rezultateve <i>Sqarim:</i> Rezultatet e pritura të syllabusit janë të përpiluara konform rezultateve të pritura të programit, në përputhje me standardet e AKA-së. *Njohuri (Nj) **Aplikim-Kompetenca (A-K) ***Aftësi (A)			
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënës të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/numerike	2	15	30
Punë praktike	1	5	5
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Kollokiume, seminare	2	2	4
Përgatitja përfundimtare për provim	1	15	15

Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	1	5	5
Projektet, prezantimet ,etj	2	3	6
Totali			125
Sqarim: 1 orë = 25 ECTS kredi.			
Përshtatja e ECTS me orët totale: 125 orë ÷ 25 = 5 ECTS kredi.			
Metodologjia e mësimdhënies:	Studentët duhet të jenë pjesëmarrës aktivë të procesit mësimor. Mësimi aktiv kërkon që studentët të reflektojnë mbi gjërat që diskutohen e jo të jenë pranues pasivë të informatave që u jepen. Ata janë inkurajuar që të shtrojnë pyetje. Po ashtu do të organizohet edhe puna grupore, në mënyrë që studentët të diskutojnë çështjet relevante dhe të këmbëjnë mendimet e tyre. Natyrisht, paraprakisht do të kërkohet leximi dhe thellimi në literature relevante të lëndës.		
Metodat e vlerësimit:	- Aktiviteti ne ligjërata 0-10% - Kollokviumi i parë: 0-20% - Kollokviumi i dytë: 0-20% - Punimi dhe prezantimi 20% - Provimi përfundimtar 0- 30%		
Literatura			
Literatura bazë:	- Mishkin, F. S., The Economics of Money, Banking, and Financial Markets, Global Edition [12 ed.], 2019 - Sulo Hadri “Paraja, bankat dhe tregjet financiare“ , Agafer, Tiranë 2006		
Literatura shtesë:	- Walsh, Carl E., Monetary Theory and Policy, MIT Press, 2nd ed., 2003 - Mishkin, F. S., The Economics of Money, Banking, and Financial Markets, Columbia University, 9th ed., 2010 - Bain, K. and Howells, P.G.A., 2003, Monetary Economics: Policy and Its Theoretical Basis, New York: Palgrave MacMillan		

Plani i dizajnuar i mësimit:

Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	Prezantimi i lëndës / Syllabusi
Java e dytë:	Hyrje, paraja dhe funksionet e saj
Java e tretë:	Instrumentet dhe tregjet financiare
Java e katërt:	Teoria e sjelljes së normave të interesit
Java e pestë:	Llojet dhe llogaritja e normave të interesit
Java e gjashtë:	Institucionet financiare
Java e shtatë:	Testi I-rë
Java e tetë:	Politika Monetare dhe Monedhat Dixhitale
Java e nëntë:	Mekanizmi i Transmetimit të Politikës Monetare
Java e dhjetë:	Rregullimi dhe mbikëqyrja e sistemit bankar
Java e njëmbëdhjetë:	Kurset ndërkombëtare të këmbimit
Java e dymbëdhjetë:	Pavarësia e Bankës Qendrore
Java e trembëdhjetë:	Politika Monetare dhe Ndryshimet Klimatike
Java e katërmëdhjetë:	Prezantimi i punimit
Java e pesëmbëdhjetë:	Testi II-të

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:**Politikat e mirësjelljes konform statutit të UHZ-së.**

Para së gjithash, studenti duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të respektojë institucionin dhe rregullat shkollore;

- Duhet të respektojë orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe të jetë i vëmendshëm në orën mësimore;
- Është i obliguar posedimi dhe paraqitja e indeksit dhe mjetit të identifikimit në teste dhe provim;

- Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studenti duhet ti përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësuesi për realizimin hulumtues dhe teknik të punimit;
- Testet dhe provimet vlerësohen individualisht për secilin student. Prandaj, studentet duhet të përqendrohen vetëm në njohuritë personale.
- Shkelja eventuale e këtyre parimeve etike (rregullave) ndëshkohet sipas normave të parapara me ligj.